



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.39, datë 26.12.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“KOMPLEKS TURISTIK “PRINC ADRIATIK RESORT”, RESORT ME SUITA 1, 2, 3, 4  
DHE 5 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËN TOKË”, ME VENDNDODHJE NË  
BASHKINË LEZHË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Prince Adriatik Resort” sh.p.k dhe “Prince Junior” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,


VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks turistik “Princ Adriatik Resort”, Resort me suita 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë”, me vendndodhje në Bashkinë Lezhë, me subjekt zhvillues shoqëritë “Prince Adriatik Resort” sh.p.k dhe “Prince Junior” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Lezhë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit

KRYETARI  
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 04 / 09 / 2024